

## **RAPORT I DETAJUAR I TRAJNIMIT**

**Titulli:** Korniza e Kurrikulës së Kosovës – Programi Parafillor

**Data:** 9 dhjetor 2023

**Vendi:** Salla A-208

**Trajnere:** Diana Qarkaxhija

### **Qëllimi i trajnimit:**

Ky trajnim kishte për synim që pjesëmarrësit të kuptojnë në mënyrë të plotë përmbajtjen, strukturën dhe filozofinë e **Kornizës Kurrikulare të Kosovës (KKK)** me fokus të veçantë në programin parafillor. Qëllimi kryesor ishte që ata të jenë të aftë të planifikojnë dhe zbatojnë procesin mësimor në përputhje me standardet dhe qasjet bashkëkohore të përcaktuara në këtë dokument themelor.

### **Përmbajtja e trajnimit:**

#### **1. Struktura e Kornizës Kurrikulare të Kosovës (KKK):**

- U prezantua struktura dhe dokumentet përcjellëse të KKK-së.
- U sqaruan parimet e ndërtimit të kurrikulës dhe vlerat udhëzuese për edukimin e hershëm.

#### **2. Fushat e të nxënit dhe kompetencat kyçe:**

- Trajnimi theksoi rëndësinë e zhvillimit të kompetencave bazë: komunikimi, të menduarit kritik, ndërveprimi, përgjegjësia dhe të nxënit gjatë gjithë jetës.
- U analizuan fushat e të nxënit si baza për organizimin e përmbajtjes edukative.

#### **3. Qasja e bazuar në kompetenca:**

- U diskutua koncepti i mësimdhënies të orientuar drejt rezultateve të të nxënit.
- Pjesëmarrësit kuptuan si të lidhin aktivitetet mësimore me zhvillimin e kompetencave.

#### **4. Planifikimi i bazuar në KKK:**

- U trajtuan në mënyrë të detajuar format e planifikimit (vjetor, mujor, ditor).

- U përdorën modele konkrete për të udhëhequr studentët në krijimin e planifikimeve të personalizuarra për grupe të ndryshme të fëmijëve.

#### 5. **Shembuj praktikë dhe analiza:**

- U prezantuan plane reale nga institucione parafillore dhe u analizua përputhshmëria e tyre me KKK.
- U inkurajua reflektimi profesional për të identifikuar mënyra përmirësimi në planifikim dhe zbatim.

#### **Rezultatet e arritura:**

- Pjesëmarrësit treguan përfshirje aktive dhe angazhim të lartë gjatë trajnimit.
- Ata u pajisën me njohuri të strukturuarra dhe praktike për zbatimin e KKK-së në edukimin parafillor.
- U zhvilluan aftësi në hartimin e planeve mësimore që përputhen me filozofinë dhe standardet e Kornizës Kurrikulare.
- Në përfundim, pjesëmarrësit diskutuan mënyrat e aplikimit të qasjes së re kurrikulare në mjediset arsimore të Kosovës.